

## AKTI I THEMELIMIT

### PËR SHOQËRINË “Alfa Import-Export” SHPK

#### FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë në datën 28 Prill 2022 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “Alfa Import-Export” shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

**Genti Jakupi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13.02.1979 lindur në Shkodër, Shqipëri dhe banues në Tiranë, Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pashaporte H90213081N.

#### SELIA E SHOQËRISË

1. Shoqëria tregëtare "Alfa Import-Export " SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e **Tirane, Tirane, TIRANE, Njesia Bashkiake Nr.10, Rruga Bogdaneve, Vila nr. 22, nr. 2**. Me vendim të ortakëve të shoqërisë , mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare “Alfa Import-Export” SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

#### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1.000 lekë (një mijë lekë), i cili është tërësisht kapital financiar . Kapitali themeltar është i ndarë në 1(një) kuotë, me vlerë nominale 1.000 lekë (një mijë lekë). Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. **Genti Jakupi**, zotërues i 1(një) kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të tjetërsojnë, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji. Kapitali fillestar nuk është paguar.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Alfa Import-Export” shpk do të jetë :

- ❖ Import eksport i produkteve ushqimore.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

#### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :
  - a- për ndryshime në statut
  - b-emërimin dhe shkarkimin e administratorit
  - c-miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.



d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit  
e-riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë, është **Genti Jakupi** me afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

**BAZA LIGJORE**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij sot me datën 28 Prill 2022.  
Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

**ORTAKËT:**

**Genti Jakupi**



Genti Jakupi  
